



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org.Jednica Org.Unit	ARPL	Nr i Prot. Broj Prot. Prot.No.	4496-2/21
Nr i Faqeve Br Stranica NoPages	- 04 -	Datë Datum: Date:	15.02.22
PRISHTINË / A			No.1

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	02.02.2022
REFERENC-Ë:	4496/21 - ARPL
PËR/ZA/TO:	„ QALLAKU PETROL ” SH.P.K, Rr.Fatmir Ukaj, Pejë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së Z. Naser AFIZI- Zëvendësues i Udhëheqësit të ARPL-së
NGA/OD/FROM:	Sylejmon LATIFI-Zyrtar Përgjegjës për Akte Ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje Ujore

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka shqyrtuar kerkesen me Nr. të protokollit: 4496/21, te dat.19.10.2021 për shkarkim të ujërave nga Seperacioni -Prodhimi zhavorri „ QALLAKU PETROL ” SH.P.K, Rr.Fatmir Ukaj, Pejë dhe ka vendosur si në Vendimin për Leje Ujore, pas plotësimit të dokumentacionit të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. L.U.46

Datë: 02.02.2022

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjensive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës „ QALLAKU PETROL ” SH.P.K, Rr.Fatmir Ukaj, Pejë me nr. protokoll.4496/21 për shkarkim të ujërave të ndotura nga Seperacioni – Prodhim zhavorri në piken me koordinata: X = 7 443 823 ; Y = 4 723 222, sipas kushteve vijuese:

1. Kjo Leje Ujore i referohet ekskluzivisht shkarkimit të ujërave të ndotura nga kompleksi i Seperacioni – Prodhim zhavorri „ QALLAKU PETROL ” SH.P.K, Rr.Fatmir Ukaj, Pejë;
2. Leja Ujore lëshohet në bazë të dokumentacionit tekniko – investiv për kompleksin e objekteve nën kushtet vijuese;
3. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (pesë) vite, me mundësi zgjatjeje sipas kërkesës së palës;

4. Analiza dhe përcaktimi i parametrave standard e projektues kualitativ të recipientit (temperatura, ph, SHBO₅, SHKO, sasia materieve të suspenduara, baktereve e ngjashëm) të përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe specifikat e recipientit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi duhet të dorezohen në MMPHI në çdo gjashtë muaj;
5. Objektet me destinim të grumbullimit, trajtimit të ujërave të ndotur dhe llumit dhe ato të shkarkimit duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të shfrytëzohen në atë mënyrë që të sigurojnë funksionalitet të plotë;
6. Nëse gjatë operimit vije deri të ndryshimi i regjimit të ujërave dhe shkaktimit të dëmeve eventuale mjedisit ose palëve të treta, investitori është i obliguar që dëmet t'i evitoj dhe t'i kompensoj;
7. Që të kryhet monitorimi në të gjitha fazat e trajtimit të efluentit duke përfshirë edhe mjedisin pritës. Rezultatet e monitorimit të raportohen në MMPHI / ARPL;
8. Obligimi financiar lidhur me shkarkimin ujërave të ndotura do të caktohet me vendim të posaçëm në rast se analizat e ujit nuk i plotësojnë kriteret sipas Udhëzimit Administrativ - UA 30/2014 për Efluent të ujërave të ndotura;
9. Të drejtat e fituara në bazë të Lejes Ujore nuk mund t'u barten personave të tretë pa pajtimin e organit i cili ka lëshuar këtë Leje Ujore;
10. Për vazhdimin e Lejes Ujore bartësi është i obliguar që të aplikoj se paku 2 (dy) muaj para skadimit të afatit të Lejes Ujore;
11. Validiteti i Lejes Ujore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të lartcekura në afatet e parapara kohore.

Arsyetim

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim për Leje ujore - shkarkim të ujërave nga kompleksi i betonierës, bashkangjitur: Dokumentacioni i kompanisë : Çertifikata e regjistrimit të biznesit - ARBK- , Plani i situacionit me përpjesë të lexueshme 1:1000, Kopja e planit , Çertifikatë e pronësis, Leje për Aktivitete të Veçanta - KPMM, , Ripelqim, Kontratë me K.R.U."Drini i Bardh " SH.A., Pejë, Çertifikata e regjistrimit e biznesit - "Geosource Consulting "Sh.p.k, Diplomë - Valmir Gani Krasniqi, Diplomë- Astrit Shala, Autorizim përmes Kompanis "QALLAKU PETROL " SH.P.K dhe hartuesit të projektit "Geosource Consulting "Sh.p.k, CD.

Faqe 3 nga 4

Faturat e pagesave për: Kushte Ujore, Pëlqime Ujor dhe Leje Ujore.

Andaj, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, akteve administrative të lëshuara nga organet kompetente, legjislacionit për ujërat për shqyrtimin e aplikacioneve për akte ujore, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr: 4496/21- ZSP- 2022, Datë: 02.02.2022

Prishtinë

T'i dërgohet :

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së
- Inspektoratit të MMPHI-së
- Komuna e Pejës
- Arkivit të Ministrisë.

Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së

Izedin BYTYQI